



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.147 dt.29.09.1997

Këshilli Bashkiak, i mbledhur me dt.29.09.1997, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve, Drejtoria e Financës, “Mbi gjendjen ambientale të Lanës të shkaktuar nga ndërtimet pa leje dhe vendosjen e taksës (të përkohshme) për reabilitimin dhe pastrimin e saj”, mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, dhe ligjit Nr.7777, dt.22.12.1992 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI

1. Të miratoj relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve, Drejtoria e Financës “Mbi gjendjen ambientale të Lanës të shkaktuar nga ndërtimet pa leje dhe vendosjen e taksës(të përkohshme për reabilitimin dhe pastrimin e saj).
2. Vlera e taksës të jetë 50 lekë/m² në muaj propocional me sipërfaqen aktive të ndërtesës.
3. Brenda muajit Tetor Ndërmarrja e Gjelbërimit dhe Ndërmarrja e Tregut të Lirë të evidentojnë sipërfaqen aktive të ndërtimeve në Lanë dhe në muajin Nëntor të filloj vjelja e taksave.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve, Drejtoria e Financës.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

